

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detaje nga atentati në Sarandë/ Viktima tentoi të largohej sapo pa autorët! U qëllua në mes të rrugës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/detaje-nga-i-ne-sarande--tentoi-te-largohej-sapo-pa-utore-i587235
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 10:26:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 10:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6b0237ced0965ca4db70942d545f7a98a36b5a6e0ff419469a7d9db24e75c0f2
TEKSTI	64bda8c17895464590a294497b38b305cafb4648653f4a3538eac1b7ac336901
PAMJA	2cb7dfbf09b6f9a3084b13ca9701601b4634154d063af49d8668c18b6a315058

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e14f264dcbffc72ac9d20269c588ce44302e93c8916e7c11c4c7a3d06c3362d3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e14f264dcbffc72ac9d20269c588ce44302e93c8916e7c11c4c7a3d06c3362d3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)

English

[Mediat ruse e serbe e paraqesin protesten ne T'rane si "trazira" per shkak te denimit te ish-krereve te UÇK-se9.2 milione turiste ne tete muaj, fluks rekord ne Rinas! Demc fundit](#)

Detaje nga atentati në Sarandë/ Viktima tentoi të largohej sapo pa autorët! U qëllua në mes të rrugës



20 Shtator 2026, 12:40Kronika TEMA



44-vjeçari Artan Murtaj, i cili u vra në Sarandë, sapo ishte ulur për kafe në një lokal pranë kryqëzimit të ish-agjencia, kur dy autorët, që kishin ardhur nga rruga "Lefter Talo", iu afruan dhe qëlluan të paktën dy herë.

Kafja ndodhet në mes të qytetit të Sarandës, ndërsa 44 vjeçari sapo ka pikasur autorët tentoi të të largohej me vrap drejt rrugës "Vangjel Pandi".

Dyshohet se të dy autorët kanë qëlluar me armë zjarri dhe ai u vra në mes të rrugës.

Viktima 44-vjeçar që u vra me armë zjarri në Sarandë njihej si "Tani Ruzhdiut". Ai ishte me precedentë të shumtë penalë, i përfshirë një plagosje një vit më parë.

I plagosur edhe një kalimtar rasti, Xhevdet Skëndaj, i cili po priste për punë dhe e ka kapur plumbi rikohetë. Atentati në qendër të Sarandës nga dy persona të maskuar të hipur mbi një motor.

Murtaj rezultoi i përfshirë në ngjarjen e 17 korrikut 2025 në lagjen nr.4 Sarandë, ku u plagosën me armë zjarri Ernest Lama dhe Gëzim Hajdaraj nga Kamza.

Autor i plagosjes ishte Ramadan Zoto 44 vjeç, ndërkohë që Artan Murtaj, Klaus Jaçaj dhe Erjon Canaj e ndihmuan atë në ngjarje dhe gjatë arratisjes.

Pas kësaj ngjarje, në Sarandë nisi një sagë hakmarrje, ku u vra me tritol babai i Klaus Jaçaj, Isuf Jacaj, ndërkohë që pati edhe një rast shkatërrimi prone të Ramadan Zotos.

Aktualisht në burg për plagosjen e Lamës dhe Hajdaraj është Ramadan Zoto, ndërsa Artan Murtaj dhe Klaus Jaçaj, të cilën u akuzuan për "përkrahje të autorit të krimit", janë liruar para pak kohësh. Në kërkim mbetet vetëm Erjon Canaj.

Artan Murtaj gjithashtu njihet si përdorues i lëndëve narkotike dhe i dënua më parë për "vjedhje".



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Vrasja e 44-vjeçarit në Sarandë, Policia del me njoftim zyrtar: I plagosur dhe një kalimtar, pika kontrolli për kapjen e autorëve](#)

11:40 Kronika / 1 koment

Vrasja në Sarandë, kush është viktimi i njohur si "Tani Ruzhdiut", sapo ishte liruar nga burgu pas një plagosjeje në 2025

10:50 Kronika / 6 komente

Kishin fshehur në autobus mallra të kontrabanduara nga Greqia dhe mbi 22 mijë euro, arrestohen 2 persona në Gjirokastër

10:40 Kronika

Të shtëna me armë në qendër të Sarandës, vritet një person (EMRI)

10:16 Kronika / 8 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.